

Hapet thirrja për bursa për trajnim për stafin akademik të Universitetit të Tiranës për trajnim në kuadër të Programit Erasmus +, në Universitetin Eberswalde në Gjermani.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Eberswalde në Gjermani, për stafin akademik për trajnim të Universitetit të Tiranës.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim;

Fushat e trajnimit dhe kohëzgjatja:

- Forest landscape restoration 18.06.2018 – 22.06.2018;
- E-Tourism 04.06.2018 – 20.06.2018;
- Tourism in Developing Countries 25.06.2018 – 13.07.2018;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (120 EUR në ditë për 15 ditët e para, për ditët pasardhëse kompensimi është 60 EUR në ditë)

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik për trajnim:

- CV(në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze/gjermane) ku të theksohet arsyeja e ndjekjes së këtij kursi
- Vërtetim punësimi në Gjuhën shqipe;
- Certifikata e gjuhës së huaj angleze ose gjermane (niveli B2);
- *Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

**Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikim: **17 Prill 2018**

Për të aplikuar dokumentat dorëzohen dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!